

KUSHTET E PERGJITHSHME TE OFRIMIT TE SHERBIMIT

TERMAT DHE KUSHTET E SHËRBIMIT PUBLIK WI-FI TË ROKiT Cities

Këto terma dhe kushte ("Kushtet e Përdorimit") rregullojnë aksesin dhe përdorimin tuaj të shërbimit të internetit publik Wireless (WiFi) të ROKiT ("Shërbimi").

Në rast se nuk jeni dakord me Termat e Përdorimit, ju lutem mos hyni, mos aksesoni dhe mos përdorni dhe/ose shfletoni Shërbimin.

Në të kundërt do të konsiderohet se **keni kuptuar dhe keni rënë dakord me Termat e Përdorimit;**

aksesi, shfletimi dhe përdorimi juaj i Shërbimeve do të konsiderohet si pranim i Termave të Përdorimit; dhe Juve bini dakord që ato janë shprehimisht detyruese ndaj jush si më poshtë vijon,- dhe sic ato ndryshojnë herë pas here - duke qënë kështu Përdorues.

Ju mund të hyni, aksesoni, përdorni, dhe / ose shfletoni Shërbimin vetëm nëse keni kryer pagesën e tarifës përkatëse të shërbimit, me parapagim, me kushtin që aksesin, shfletimin dhe përdorimin i juaj i Shërbimeve është nën përgjegjësinë tuaj dhe se ROKiT nuk ka dhe as nuk mban asnjë përgjegjësi në lidhje me aksesin, shfletimin apo përdorimin tuaj të Shërbimit duke përfshirë pa kufizim kufizimin e moshës, sigurisë së shërbimit etj. Aksesin, përdorimin dhe/ose shfletimin i Shërbimit ka si qëllim vetëm përdorim personal dhe se ajo nuk duhet të përdoret për veprimtari tregtare, duke përfshirë rishitjen etj.

Pavarësisht nga sa më sipër, bazuar në dispozitave ligjore, ROKiT ka të drejtë:

- ❖ të vendosë kufizime ndaj çdo Përdoruesi në lidhje me aksesin, përdorimin dhe/ose shfletimin e Shërbimit, dhe ndryshimit të tyre perkatesisht; Aksesin në Shërbim mund të bllokohet, pezullohet ose ndërpritet në çdo kohë për shkaqe që përfshijnë, por që nuk kufizohen në shkeljen e ligjeve dhe rregullave në fuqi, shkeljen e Kushteve të përdorimit, veprimeve që mund të çojnë në përgjegjësinë e ROKiT, ndërprerjen e aksesit për përdoruesit ose rrjetet e tjera, arsye sigurie etj.
- ❖ të imponojë dhe zbatojë një politikë të Drejtë Përdorim mbi përdorimin e internetit dhe ndryshimit të tyre perkatesisht;
- ❖ të zbatojë uljen e shpejtësisë mbi bazë përdorimi, dhe ti ndryshojë ato perkatesisht;
- ❖ të tarifikojë aksesin, përdorimin dhe/ose shfletimin e shërbimit pas njoftimit paraprak të abonentit; dhe të bëjë cdo ndryshim të tyre;
- ❖ ti rishikojë në cdo kohë këto terma dhe kushte sic e gjykon të përshtatshme. Juve duhet të bini dakord me ndryshimet e Kushteve të Shërbimit në mënyrë që të vazhdoni përdorimin e Shërbimit;
- ❖ të heqë Shërbimin, të ndryshojë specifikimet ose mënyrën e përdorimit të Shërbimit, të ndryshojë kodet e aksesit, emrat e përdoruesve, fjalëkalimet ose informacione të tjera të sigurisë të nevojshme për akses në shërbim.
- ❖ ti ofrojë asistencë dhe informacion organeve të zbatimit të ligjit, agjencive shtetërore dhe autoriteteve të tjera siç kërkohet nga legjislacioni detyrues në fuqi;

ROKiT nuk do të mbledhë asnjë të dhënë kur ju të hyni, aksesoni, përdorni shfrytëzoni dhe / ose shfletoni Shërbimin, përveçse për veprimin e hyrjes / daljes që do të shfaqet tek Përdoruesi në portalin e aksesit publik wireless të ROKiT për arsye transparence me qëllim për ti mundësuar Përdoruesit që të jetë në dijeni mbi volumin dhe kohëzgjatjen e internetit të përdorur. Në çdo

rast informacioni i mbledhur mund të përdoret vetëm në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi në lidhje me grumbullimin dhe mbrojtjen e të dhënave.

ROKiT do t'ju ofrojë një fjalëkalim për të aksesuar njëherë në Shërbim;

ROKiT ju rekomandon që të mos përdorni Shërbimin për të transmetuar ose për të marrë ndonjë informacion ose të dhëna konfidenciale në të kundërt ju ndërmerni një veprim të tillë nën përgjegjësinë tuaj.

Ju jeni në dijeni dhe bini dakord që:

Shërbimi mund të ketë ndërprerje ose difekte;

Pajisja juaj mund të jetë e ekspozuar ndaj viruseve ose aplikacioneve të tjera të dëmshme përmes Shërbimit, të cilat janë jashtë kontrollit dhe përgjegjësisë së ROKiT;

ROKiT nuk garanton sigurinë e shërbimit dhe që palët e treta të paautorizuara të mund mos kenë akses në pajisjet / kompjuterin e instaluar tuajin, ose në skedarët tua, ose të monitorojnë lidhjen tuaj;

Shërbimi ofrohet mbi bazën "siç është", "sicc disponohet" pa garanci të asnjë lloji.

Ju nuk duhet ta përdorni Shërbimin për akses në Shërbimet e Internetit, ose të dërgoni ose të merrni përmbajtje, të cilat:

- Janë diskriminuese, shpifëse, kërcënuese, frikësuese ose që mund të klasifikohen si ngacmime;
- Përmbajnë gjuhë ose material të turpshëm, profan ose abuziv, përmbajnë materiale pornografike;
- Përmbajnë imazhe fyese ose nënçmuese në lidhje me gjininë, racën, fenë, ngjyrën, origjinën, moshën, paaftësinë fizike ose mendore, gjendjen mjekësore ose orientimin seksual;
- Përmbajnë materiale që cenojnë të drejtat e palëve të treta (duke përfshirë të drejtat e autorit dhe / ose të drejtat e pronësisë intelektuale);
- Janë mesazhe të mëdha dhe / ose komerciale;
- Përmbajnë qoftë në tërësi ose pjesërisht kokë të falsifikuar ose keqinterpretuese mesazhi, për të maskuar origjinalin e mesazhit;
- Janë aktivitete që pushtojnë privatësinë e tjetrit; ose janë të paligjshëm ose të papërshtatshme;

Ju nuk duhet ta përdorni shërbimin për tu aksesuar në mënyrë të paligjshme ose pa autorizim në kompjutera, llogari, pajisje ose rrjete që i përkasin një pale tjetër, ose të përpiqeni për të depërtuar në masat e sigurisë të një sistemi tjetër. Kjo përfshin çdo aktivitet që mund të përdoret si pararendës ndaj një tentative depërtimi në sistem, duke përfshirë por duke mos u kufizuar skanimet e porteve, skanimeve të vjedhura ose aktiviteteve të tjera të mbledhjes së informacionit.

Ju nuk duhet ta përdorni shërbimin për përhapjen e Viruseve të Internetit ose programet kompjuterike dëmtuese.

Ju nuk duhet ta përdorni Shërbimin për t'u angazhuar në ndonjë aktivitet që përbën ose është në gjendje të përbëjë një vepër penale, qoftë në territorin shqiptar ose në ccdo vend të botës.

Në asnjë rrethanë ROKiT nuk do të jetë përgjegjëse për dëmet e rëndësishme, indirekte, të veccanta, ndëshkuese, qoftë të parashikueshme ose të paparashikueshme, bazuar në

pretendimet e përdoruesit të Shërbimit (duke përfshirë por duke mos u kufizuar në aksesin e paautorizuar, dëmtimin ose vjedhjen e sistemit tuaj ose të dhënave tuaja, pretendimeve për humbjen e emrit të mirë, pretendimeve për humbjen e të dhënave, përdorimit ose besueshmërisë së shërbimit, ndërprerjes së punës tjetër ose dëmtimit të aseteve të tjera, ose dëmtimit të shkaktuar ndaj pajisjeve ose programeve nga ndonjë virus ose ndonjë aplikacion tjetër i dëmshëm).

Ju bini dakord të mbani të padëmtuar ROKiT -in nga çdo pretendim, detyrim, humbje, dëmtim, kosto, ose shpenzim (duke përfshirë pa kufizim pagesat e arsyeshme të avokatit) që rrjedhin nga ose që lidhen me përdorimin tuaj të Shërbimit, çdo material i shkarkuar ose i ngarkuar përmes Shërbimit, çdo veprim i ndërmarrë nga ana juaj në lidhje me përdorimin tuaj të Shërbimit, çdo shkelje të të drejtave të cdo pale të tretë ose shkelje të ligjit ose rregulloreve, ose ndonjë shkelje e këtyre Kushteve të Përdorimit. Ky Nen nuk do të interpretohet për të kufizuar ose përjashtuar çdo pretendim ose mjet juridik që ROKiT mund të pohojë sipas ligjit.

Duke rënë dakord me kushtet e shërbimit konfirmoj që unë pranoj Kushtet e Përdorimit si bazë për hyrjen, aksesin, përdorimin dhe / ose shfletimin e Shërbimit.